

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies
au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO**

TRANSKRIPT

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS
TË MBAJTUR MË 27.10.2006**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA
ODRŽANE 27.10.2006.god.**

TETOR - OKTOBAR 2006

RENDI I DITËS

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Koha për pyetjet e deputetëve,
3. Shqyrtimi i raportit të Zyrës së Auditimit Gjeneral për të gjeturat faktike në Kuvendin e Kosovës (shpërndarë deputetëve më 6 tetor 2006),
4. Shqyrtimi i raportit për punën e Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit për vitin 2005 (materiali bazë është shpërndarë më 12 shtator, ndërsa materiali plotësues më 24 tetor 2006).

ДНЕВНИ РЕД

1. Усвајање дневног реда,
2. Време за посланичка питања,
3. Разматрање Извештаја Канцеларије Генералног Ревизора о чињеничном стању у Скупштини Косова (достављен посланицима 6.октобра 2006.год.),
4. Разматрање Извештаја о раду Регулативног Ауторитета за Телекомуникацију за 2005. годину (основни материјал је достављен 12. септембра 2006. године, док допунски материјал 24.октобра 2006. године).

Mbledhjen e kryesoi kryetari i Kuvendit Kolë Berisha

Mbledhja u mbajt në sallën e Kuvendit të Kosovës

Mbledhja filloi në orën 10,00

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Të nderuar kolegë deputetë të nderuar ministra, mirë se keni ardhur në seancën plenare të Kuvendit të Kosovës. Ju njoftoj se në sallë janë 75 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për punë. Andaj propozoj ta fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës.

Fjalën e ka deputeti Alush Gashi.

DEPUTETI ALUSH GASHI – I nderuari z. kryetar i Kuvendit. Materiali për pikën e tretë të rendit të ditës ka ngatërrim. Më 6 tetor 2006 në shkresën 022628 për deputetë të Kuvendit të Kosovës të dërguar nga Ismet Krasniqi, sekretar i Kuvendit, në rubrikën subjekti ,shkruan: Raport i auditimit të jashtëm, ndërsa në letrën që juve personalisht ua ka dërguar Zyra e Auditorit Gjeneral ,të cilën ju e keni marrë më 3 korrik të vitit 2006,që lidhur me këtë çështje, ndër të tjera qëndron se intervista formale në menaxhmentin e Kuvendit nuk ka pasur dhe se këto të dhëna janë burimore të një burimi të dhe të paverifikuara .

Në letër Zyra e Auditorit Gjeneral vazhdon: Saktësia dhe plotësia e këtyre informatave dhe e dokumentacionit është marrë dhe nuk është testuar në ndonjë mënyrë, procedurat që ne i kemi kryer, thotë Zyra e Auditorit Gjeneral, nuk përbajnjë auditim dhe si të tilla nuk përbajnjë as opinionin e auditimit dhe në asnje fushë Në paragrafin e fundit të letrës që ju e keni marrë më 3 korrik Zyra e auditorit gjeneral, z. kryetar, përfundon. Juve ju shkruan se ne jemi në proces të finalizimit të auditimit tonë me pasqyrat financiare të Kuvendit të Kosovës për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2005 dhe është pritur të jepin opinion të kualifikuar të auditimit dhe mundësi që ne mund të heqim dorë nga dhënia e opinionit. Në bazë të shkresës së zyrës së auditorit gjeneral, z. kryetar, ky nuk është auditim. Këtë material më 4 tetor 2006 e ka shqyrtuar Komisioni për Buxhet dhe Financa i Kuvendit të Kosovës që ndër të tjera përfundon: Meqenëse procedurat që janë kryer nuk përbajnjë auditim dhe si të tilla nuk e përbajnjë opinionin e auditimit, ne presim që zyra e revizionit gjeneral ta finalizoj procesin e auditimit me pasqyrë financiare të Kuvendit për vitin 2006 , ku do të kemi edhe opinionet e kualifikuara. Andaj, z. kryetar, duke mbështetur transparencën e plotë financiare në institucionet e Kosovës e në veçanti në Kuvendin e Kosovës, kërkojmë të leni kohë që të përfundojë auditimi dhe ai material i auditimit të plotë të jashtëm të vijë në Komisionin për Buxhet dhe t'i shohim vendimin e qëndrimin e Komisionit për Buxhet se si të veprojmë me rekomandime. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputetja Fatmire Mulhaxha – Kollqaku.

DEPUTETJA FATMIRE MULHAXHA – KOLLQAKU - Faleminderit z. kryetar, dëshiroj të paraqes një mocion për ndryshimin e rendit të ditës.

Në bazë të Rregullores së punës së Kuvendit d.m.th. 23.2 dhe në emër të Grupit Parlamentar Ora kërkojmë që raporti i Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale mbi monitorimin e Ligjit për shëndetësi të futet si pikë e veçantë e rendit të ditës në seancën e sotme dhe rregulla 53 e Rregullores së punës së Kuvendit përcakton qartë se komisionet parlamentare pas zbatimit të ligjeve duhet t'i raportojnë Kuvendit, por habit fakti që edhe pse është dashur të radhitet në seancën e kaluar, pse kjo nuk ndodhi sot, kur edhe deklarativisht të gjitha grupet parlamentare i dhanë përkrahje këtij raporti, për më tepër duke u nisur nga gjendja e rëndë, tejet e rënd që dominon në fushën e shëndetësisë sot në Kosovë, ne mendojmë që shqyrtimi i këtij raporti veçse do t'i kontribuojë që t'i fuqizojë rekomandimet e Komisionit të cilat do t'u shërbejnë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Qeverisë përmirësimin e gjendjes aktuale. Kjo është praktikë e të gjitha Kuvendeve të tjera dhe nuk duhet të habitemi se është me procedura shumë të irregullta dhe është miratuar edhe në Rregulloren e punës së Kuvendit një procedurë e tillë, d.m.th. Komisioni së paku 1 herë në vit duhet t'i raportojë këtij kuvendi për punën e vet dhe ne presim që kjo sot të radhitet si pikë e rendit të ditës. Ju faleminderit !

KRYETARI I KUVENDIDT KOLË BERISHA – Fjalën e ka deputeti Gani Koci.

DEPUTETI GANI KOçi - Faleminderit z. kryetar. E kemi lexuar fletëprécjelljen e auditorit gjeneral lidhur me gjendjen e Kuvendit të Kosovës. Dua të flas në këtë rast edhe si anëtar i Komisionit për Buxhet. Këtë raport e kemi pasur në dorë dhe po habitem pak me konstatimet dhe vendimet që kanë dalë nga ky komision. Nga komisioni vendimi ka qenë i tillë, por nëse ka ndryshuar gjatë procedurave ose shkrimit të tij është diçka tjetër, por që është kërkuar nga Kryesia e Kuvendit që Kryesia të marrë vendim që ky raport të dalë dhe të shqyrtohet në Kuvend. Ky ka qenë vendimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa i Kuvendit të Kosovës.

Nëse është përcjellë ndonjë shkresë tjetër atëherë do të dëshiroja të krahasonet ajo shkresë me procesverbalin e mbledhjes së Komisionit për Buxhet dhe Financa.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA - Ju faleminderit, fjalën e ka deputeti Nazim Jashari .

DEPUTETI NAZIM JAHSARI - Faleminderit z. kryetar, z. kryeministër, të nderuar kolegë deputetë.

Lidhur me çështjen që e shtroi z. Gashi nga Grupi Parlamentar i LDK –së mendoj se ky kuvend tash e ka futur në procedurë raportin e të gjeturave faktike në Kuvendin e Kosovës. Ne kemi debatuar lidhur me atë raport dhe për më tepër në këtë kuvend ka njerëz që janë suspenduar nga puna për shkak të atij raporti, prandaj të tërhiqemi tash nga diskutimi lidhur me gjeljet faktike të auditorit gjeneral vetëm për atë se ai nuk i ka dhënë rekomandimet ose referencat në ligjin përkatës mendoj se është e pakuptimshme përderisa tashmë jemi në procedurë të mirëfilltë të analizës së punës së Kuvendit në periudhën e vitit 2005. Mendoj se ne duhet të vâzhdojmë konform rendit të ditës të

diskutojmë, t'i nxjerrim rekomandimet e nevojshme, ky kuvenit t'i miratojë ato rekomandime dhe të vazhdojmë punën më tutje. Njëkohësisht e përforcoj kërkesën e Fatmire Mulhaxhës lidhur me analizën e raportit të Komisionit për Shëndetësi dhe mendoj se kjo praktikë duhet të instalohet në Kuvendin e Kosovës që komisionet të raportojnë në Kuvend, se janë trupa të Kuvendit dhe duhet të raportojnë në Kuvend, përmes monitorimin ose mbikëqyrjen e ligjeve. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDTI KOLË BERISHA – Unë do ta jap një njoftim sa përmirësoj. Po ju sqaroj se ky raport përbëhet prej dy pjesëve. Raporti që quhet Raporti i të gjeturave faktike që është dokument i analizuar dhe voluminoz dhe ka gjithsej 80 faqe, pjesa tjetër që quhet Pasqyra e arkëtimeve përvitit 2005 që është përfshirja sintetike e pjesës së raportit të të gjeturave faktike. Kjo pjesë ka gjithsej 5 faqe dhe publikohet në Uebfaqen e kompanisë pasi është bërë nënshkrimi nga ana jonë.

Raporti i të gjeturave faktike, draftraprotin e parë nga kompania që e ka bërë auditimin e kemi marrë më 5 qershor të vitit 2006. Kemi pasur kohë, dy javë, që ta lexojmë këtë tekstrit përvitit dhënë vërejtjet dhe sugjerimet tona. Natyrish se brenda kësaj kohe i kemi informuar se nuk kemi vërejtje substanciale dhe se kemi dhënë pëlgimin që ky dokument të marrë formën e prerë ose të raportit final. Por me gjithë premtimet se kjo do të bëhet përvitit disa ditë një gjë e tillë nuk ka shkuar shpejt, kështu që versioni final na është dorëzuar më 3 korrik të vitit 2006, gjithashtu na është thënë se së shpejti do të përgatitet edhe pjesa tjetër, pasqyra e arkëtimit dhe e pagesave. Pasqyra dhe arkëtimi përvitit 2005 është vonuar. Të shumtën e rasteve ka pasur edhe gabime teknike dhe përbajtjesore, ka pasur raste kur kopjet në gjuhën shqipe dhe atë angleze kanë qenë të kundërtë, kështu që disa herë të kërkojmë nga kompania përvitit bërë përmirësimet e nevojshme. Përfundimisht versioni final i pjesës Pasqyra e arkëtimit dhe e pagesave përvitit 2005 e kemi marrë ar më 24 gusht 2005 dhe e kemi nënshkruar një ditë më vonë. Krahas kësaj vonese nga kompania që e ka bërë auditimin shpërndarjen e këtij raporti te ju më herët nuk e kemi bërë edhe nga kërkesa që ka ardhur nga ana Guarda de Finansa dhe në takimin që e kemi pasur me ta kanë kërkuar të mos e shpërndaja këtë dokument deri sa ta lejojnë ata, arsyje ka qenë se ka dyshime se jo gjithherë është respektuar Rregullorja mbi shpenzimet e parave publike, prandaj deri në fillim të shtatorit edhe nga ana e tyre është kërkuar që të mos shpërndahet dhe të mos diskutohet ky raport dhe ne e kemi shpërndarë dhe e kemi vënë në rend të ditës kur ata kanë konsideruar se nuk e dëmton më procedurën e hetimeve, d.m.th i kemi pritur krejt afatet që ata i kanë paraparë. Unë nuk shoh diçka substanciale që duhet të hiqet nga rendi i ditës, me gjithë atë ne mund të votojmë përvitit këtë dhe të vendosim.

Fjalën e kërkon Alush Gashi.

DEPUTETI ALUSH GASHI – Z. kryetar shfrytëzojmë Rregulloren e punës së Kuvendit me kërkesë që ta hidhni në votim propozimin tonë që kjo pikë e rendit të ditës të vij plotë si auditim i jashtëm me rekomandime. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e kërkon Jakup Krasniqi.

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI – Z. kryetar, të nderuar deputetë, z. kryeministër. Unë në emër të grupit parlamentar kërkoj që nëse votohet përvitit këtë pikë të rendit të ditës, para se të votohet ne kërkojmë një pauzë përvitit konsultuar, por unë kisha kërkuar nga grupi

parlamentar i LDK-së, ta respekojmë fuqinë e tyre numerike. Mirépo kérkoj tē vihen nē shërbim tē punës së papengueshme të Kuvendit, tē vihen nē shërbim tē mbrojtjes së ligjit, tē vihen dhe tē jenë tē vendosur pér tē luftuar dukuritë negative pér tē cilat ka kohë që flitet shumë nē Kosovë e nē mënyrë tē veçantë, tē nderuar deputetë ky raport edhe pse i kufizuar edhe pse i mangët edhe pse nē tërësinë e tij na i vizaton keqpërdorimet që janë bërë nga kryetari i Parlamentit, nga stafi i tij administrativ dhe nga shumë trupa ekzekutiv që i kemi zgjedhur ne nē këtë Parliament dhe mendoj se nëse nuk ndërpritet kjo praktik e shkeljeve tē ligjit dhe kjo praktikë e mbrojtjes së krimit dhe korruptionit me thënë ma shkurt e vjedhjes së buxhetit tē konsoliduar tē Kosovës vërtet ne tregohemi se jemi tē papërgjegjshëm edhe pér sot edhe pér nesër, ne jemi kundër shtyries, jemi pér debatimin e këtij debati pér këtë pikë tē rendit tē ditës, nëse jo ne kérkojmë pauzë tē konsultohem me grupin se nuk duam tē jemi pjesëmarrës dhe mbrojtës i njerëzve që kanë vjedhë nē mënyrën më tē paskrupullt buxhetin e Kosovës e nē këtë rast buxhetin e Kuvendit tē Kosovës.

KRYETRI I KUVENDIT KOLË BEREISHA – Ju faleminderit, fjalën e ka Gjylnaze Syla.

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA – Ju faleminderit. I nderuari z. kryetar, z. kryeministër, anëtarë tē kabinetit Qeveritar, deputet tē nderuar.

Grupi Parlamentar i AAK-së është i përkushtuar pér një qeverisje tē mirë, menaxhim tē mirë dhe efektiv e produktiv tē mjeteve publike dhe dënon çdo lloj keqpërdorimi tē tyre. Konsiderojmë se Kuvendi i Kosovës duhet tē jetë shembull i ndërgjegjes, përgjegjësisë dhe transparencës, megjithëkëtë nē reportin e auditorit sidomos pér reportin pér tē gjeturat faktike, ne kemi vërejtur se ky rapport nuk përmban konkluzione se nē çfarë përmasash janë shkelur ligjet dhe rregullat financiare, prandaj jemi tē gatshëm nëse Kuvendi do tē diskutojë dhe megjithatë mendoj se duhet ta vini nē votim propozimin e LDK-së. Sa i përket kërkësës së Orës pér shqyrtimin e rapporti tē Komisionit pér shëndetësi, nuk është nē rend tē ditës. Ne e kemi shprehur mendimin edhe nē seancën e mëparshme që tē diskutojmë pér këtë dhe nē ndonjëren prej seancave tē ardhshme mendojmë se duhet tē vihet nē rend tē ditës, por sot nuk jemi tē gatshëm e as tē përgatitet tē diskutojmë pér tē. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA - Ju faleminderit, fjalën e ka deputetja Teuta Sahatqija.

DEPUTETJA TEUTA SAHATQIJA – Ju faleminderit z. kryetar. Unë i bashkangjitem kërkësës së kolegut tim tē opozitës Jakup Krasniqi. Mendoj se kemi pasur kohë mjaft, jemi tē informuar një kohë tē gjatë pér rapportin e auditimit. Rendi i ditës është caktuar nga Kryesia, nē Kryesi janë tē gjithë anëtarët e grupeve tē ndryshme parlamentare. Ka pasur mjaft kohë që tē stopohet, bille sipas rregullores së re, rendi i ditës ndërrrohet me shkrim përpëra se tē fillojë seanca. Pér këtë nuk jam nē dijeni se a ka pasur kërkësë me shkrim pér ndërrimin e rendit tē ditës, mendoj që çfarëdo shtyerje e kësaj pike tē rendit tē ditës nuk krijon transparencë tē cilën po e kérkojmë tē gjithë, pa marrë parasysh grupet parlamentare. Mendoj që kjo nē fakt përkundrazi nuk sjell transparencë, por mostransparencë. Më 14. ka qenë pika e dytë e rendit tē ditës kërkesa pér debat pér shpenzimet buxhetore, por është shtyrë, tash përsëri po shtyhet. Mendoj që besimi i qytetarëve edhe ashtu shumë i vogël nē institucionet tona me këtë shtyre do tē zvogëlohet edhe më, me gjithë se jemi pér transparencë ne po u themi se nuk jemi pér

transparencë. Çfarëdo votimi përsëri do ta sjellë makinën votuese e cila do t'i ndihmojë mostraparencës dhe do ta lutja secilin deputet veç e veç të mendojë do të jetë pjesë e kësaj mostraparence, a do të jetë me makinën votuese që ndikon te mostraparenca. Ne jemi kundër shtyrjes. Në qoftë se nuk ka kërkesë me shkrim,sipas rregullores, nuk ekziston baza për shtyrje. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit, Numan Baliq e ka fjalën.

POSLANIK NUMAN BALIĆ – Dozvolite mi u ime grupe za integraciju da kažem nekoliko principielni stvari. Stano govorimo o proceduri, o redu, o dogovoru o poštovanju reda, međutim sada nalazimo u jednu situaciju gdje delujemo neozbilno, najpre se jedno pitanje stavlja na dnevni red, potom se traži skidanje od dnevnog reda, mislim da najlogičnije bi bilo u ovoj situaciji pošto postoji očigledno jaka konfrontacija oko mišljenja, oko daljeg toka ove sednice da se šefovi parlamentarnih grupa razgavaraju oko toga, ne bi bilo pošteno, ne bi bilo dobro da se pristupi glasanju bez prethodnog razgovora šefova poslaničke grupe, s obzirom da se radi oko vrlo važnom pitanju. Da se razumjemo da je stav grupe za integraciju takav da mi u ovom mslučaju imamo neutralnu poziciju, mislimo da je pitanje i tada kada je započelo i sada pre više ispolitizirano da treba ostaviti organima redu i organima koji se kompetentno bavi ovom pitanju a da svakako mi imamo našu poziciju koju sam napomenuo. Takođe dozvolite mi da kažem sa postavljanje u dnevnom redu izveštaj o stanje u zdravstvu koje je predožila parlamentarna grupa Ora u ime grupe za integraciju mi podržavamo da se to pitanje razmatra kao posebna tačka dnevnog reda. Hvala !

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. I kemi dy propozime: të hiqet nga rendi i ditës, propozimi i dytë që të jepet një pauzë dhe të bisedohet me shefat e grupeve parlamentare.

Fjalën e ka deputeti Gani Koci

DEPUTETI GANI KOçi – Ne jemi të vetëdijshëm që edhe sipas fletëpërcjelljes se ky nuk është raport përfundimtar i auditimit. Ju e thatë edhe se e ka pasur një kontratë për kontroll të shpenzimeve buxhetore në një periudhë të caktuar dhe kjo periudhë e caktuar ka qenë prej 1 korrikut 2004 deri më 31 korrik 2005. Për këtë raport janë dhënë edhe shuma të caktuara, është paguar ky raport që është kërkuar nga Kuvendi dhe ato shuma janë mbi 30.000 € dhe po në këtë fletëpërcjellëse, se të gjitha këto gjetje do të janë edhe pjesë të reportit përfundimtar të revizionit, meqë është kërkuar për këtë periudhë të caktuar nuk ka arsy që ky raport të mos diskutohet sot në sallë.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA - Ju faleminderit, fjalën e ka Fadil Geci.

DEPUTETI FADIL GECI – I nderuari kryetar, të nderuar deputet të Kuvendit të Kosovës,

Me debatin e hapur për këtë çështje procedurale e paraqes këtë propozim dhe pres që kjo mbledhje plenare të deklarohet: "Kërkoj që pika e rendit të ditës për auditivin të shtyhet për një seancë tjeter, sepse nuk janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara dhe nuk janë

bërë të gjitha përgatitjet që ne sot të kemi një debat të frytshëm, shterues dhe konstruktiv". Arsyetimin e këtij propozimi:

1. Nuk janë paraqitur të gjitha dokumentet relevante dhe deputetët nuk janë furnizuar me të gjitha materialet e duhura dhe të nevojshme,
2. Nuk janë bërë diskutimet dhe shqyrtimet në komisione parlamentare,
3. Nuk ka referues për këtë pikë të rendit të ditës, madje as nuk e kemi mendimin e Komisionit për Buxhet që do të mund të konsiderohej si komision funksional për këtë çështje.

Këto që i thashë secili nga ju e di, nuk është plotësuar asnjë pikë e Rregullores së punës së Kuvendit të Kosovës në të cilën është paraparë mënyra se si një çështje të futet si pikë e rendit të ditës për seancën plenare. Konsiderojmë se nëse nuk e heqim që aty nuk ka dyshim bëjmë një gabim nënçmues si institucion më i lartë përfaqësues, ligjvënës i popullit të Kosovës.

Duke marrë për bazë një material, të them të huaj që e ul dinjitetin e Kuvendit të Kosovës dhe që nuk është në kuadër të mandatit të tij, me këtë do t'u hapim rrugë për t'i vënë në në rend dite materialet e llojllojshme nga subjektet më të ndryshme që nuk përkon me mënyrën ligjvënëse të Kuvendit të Kosovës. Materiali i auditimit nuk ka karakterin e dokumentit që i duhet të shqyrtohet në Kuvend, aq më parë siç është paraparë në bazë të ligjit. Me Rregulloren e UNMIK-ut 2002/18 drejtoria e administratës dhe organet përkatëse të Kuvendit është dashur t'i japid komentet e veta që detyrimisht do të përfshihen në raportin final të auditimit të përgjithshëm(gjeneral). Kjo nuk është bërë dhe konform rregullores konsideroj se ky raport për seancën plenare mund të vijë vetëm si i inkorporuar në raportin e Komisionit për Buxhet, që do të ishte edhe referues për këtë pikë të rendit të ditës. Pasi të kishte marrë, përkatësisht komentet dhe vërejtjet me shkrim nga sekretari i Kuvendit ,përkatësisht nga drejtori i administratës së Kuvendit- si persona kompetentë dhe përgjegjës. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Unë ju kisha lutur për hir të asaj që të punojmë të gjithë së bashku në këtë sallë, të tërhoiqemi 5 – 10 minuta sa të jetë nevoja dhe të konsultohen shefat e grupeve parlamentare.

Fjalën e kërkon Alush Gashi.

DEPUTETI ALUSH GASHI – Z. kryetar i Kuvendit. Grupi ynë parlamentar në këtë seancë me propozimin e vet nuk hyn në përbajtje të këtij dokumenti që ju e keni dërguar. Lidhur me procedura, ju e keni shtruar si raport të auditimit, Zyra e auditimit gjeneral thotë se nuk është auditim, ne kërkohmë që propozimi ynë si grup parlamentar që të jetë auditim i plotë, të hidhet në votim në bazë të Rregullores së punës. Grupet e tjera parlamentare e kanë shfrytëzuar të drejtën e vet sa i përket shprehjes së pikëpamjeve, kanë shkuar me dashamirësi edhe aq shumë sa edhe na kanë udhëzuar se si do të punojmë ne si grup parlamentar. U jemi mirënjohës, por ne e kemi programin tonë, i kemi të drejtat dhe detyrimet tona. Unë e di, z. kryetar, në çfarë halli jeni ju që nuk e respektoni Rregulloren e Kuvendit që ta hidhni në votim këtë çështje. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Unë nuk kam kurrfarë zori dhe nuk kam presion nga askush. këtë duhet ta ketë të qartë secili.
Fjalën e kërkon deputeti Jakup Krasniqi .

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI - Z. kryetar, të nderuar deputetë, ju lutem nëse e keni raportin, hapeni në faqen..Më 27.. mars të vitit 2005 sekretari i Kuvendit ka kërkuar nga shefi i auditorit të prokurimit publik për përdorimin e prokurimit njëburimor ,kërkësë e bërë për 2 vatura për kryetarin e Kuvendit. Kërkesa për prokurim ka qenë në vlerë prej 750..... Z. kryetar unë jam i obliguar ta them dhe ta keni parasysh kurrë nuk kemi qenë më unikë për ta mbrojtur krimin, për ta mbrojtur korruptionin dhe për t'i mbrojtur banditët, prandaj kemi unitet kur është në të mirë të gjithë Kosovës, por për ta mbrojtur krimin siç po e mbron ti dhe ata që qëndrojnë pas teje, ne nuk do ta bëjmë kurrë.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Z. Krasniqi ju lus ta tërhiqni fjalën.....nuk jua kam dhënë fjalën. Lus shefin e Grupit Parlamentar të PDK-së ta tërheqë fjalën rrëth asaj që Grupit Parlamentar të LDK-së t'i hiqet fjala "mbrojtje e krimit".

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI - Z. kryetar, unë kërkoj më parë të tërhiqen ata që e mbrojnë krimin e nëse tërhiqen ata që e mbrojnë krimin e tërheq edhe unë fjalën.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA - Unë nuk dëshiroj të jem pjesë e asaj që këtu të mos ketë frymë uniteti. Natyrisht se jemi përfaqësues të partive politike dhe ka mendime të kundërtat, por po të ketë debat konstruktiv, të ketë edhe propozime konstruktive dhe të mos përdoret fjalori që nuk duhet të përdoret në këtë sallë, nuk mund të quhet askush kriminel as bartës i krimit, nëse nuk është vërtetuar ajo, prandaj për këtë kërkova z. Krasniqi që ju ta tërhiqni fjalën "mbrojtës të krimit" dhe mendoj se nuk kemi të drejtë as unë as ti që në këtë sallë ta akuzojmë dikë për të tillë, atë mund ta themi vetëm kur të vendosë organi kompetent.

Fjalën e kërkon Teuta Sahatçiu.

DEPUTETJA DEUTA SAHATQIJA – Z. kryetar, krejt ky kontest është për shkak të rendit të ditës. Ta lexojmë edhe një herë rendin e ditës ashtu si është shkruar. Renidi i ditës thotë: "Shqyrtimi i rapportit të zyrës së auditimit gjeneral për të gjeturat faktike në Kuvendin e Kosovës", por nuk thotë se është në rend dite auditimi i Kuvendit, por është rapporti për të gjeturat faktike. Në bazë të kësaj ne jemi pikërisht këtu për të diskutuar rapportin për gjeljet faktike, jo për auditim. Në qoftë se dëshironi që auditimi të kryhet, mund të bisedojmë prapë, kur të kryhet auditimi. Mund të diskutojmë në një seancë të veçantë për rapportin e auditivit. Ky është raport për të gjeturat faktike, plotësisht jemi në rend dite dhe nuk ka kërkësë me shkrim për ndryshimin e rendit të ditës, prandaj nëse doni ta respektoni rregulloren, me rregullore ne jemi mirë.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA - Ju faleminderit, deputeti Ymer Muhaxheri e ka fjalën.

DEPUTETI YMER MUHAXHERI - Z. kryetar e ndiej të nevojshme me rastin e paraqitjes së kryetarit të Grupit Parlamentar të LDK-së me atë insistim se është formë e

dhunës dhe me këtë formë unë nuk pajtohem dhe distancohem prej një sjelljeje dhe veprimi të tillë.

KRYETARI I KUVENDTI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. E hedh në votim rendin e ditës të propozuar për këtë seancë. Kush është për.

Fjalën e kërkon Alush Gashi.

DEPUTETI ALUSH GASHI – Z. kryetar i Kuvendit, lidhur me pikën e tretë të rendit të ditës, tri herë kërkua që për arsyen procedurale të hiqej nga rendi i ditës, ne në asnjë moment nuk kemi biseduar për përbajtjen e dokumentit që e keni shtruar dhe kategorikisht i refuzojmë klasifikimet që grupi ynë e mbron krimin. Z. kryetar ne insistojmë në transparencë dhe në respektim të plotë të gjyqësisë si institucion i pavarur, por mendojmë se rekomandimet që i ka dhënë Zyra e Auditorit të Përgjithshëm duhet të të respektohen. Kërkesa jonë në fillim të seancës është ta hidhni në votim kërkesën tonë për heqjen nga rendi i ditës.

KRYETARI I KUVENDTI KOLË BERISHA - Ju faleminderit.

Votojmë për ta hequr nga rendi i ditës këtë pikë.

Numëroni votat,

Për	48
Kundër.....	30
Abstenime	9

Sipas kësaj del se kjo pikë duhet të hiqet nga rendi i ditës.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Lus administratën t'i numërojë deputetët në sallë.

Në sallë janë 58 deputetë, do të thotë se nuk e kemi kuorumin që mund të marrim vendime.

Më duhet konsultim, prandaj e marrim një pauzë në orën 15,00 minuta.

Pauza

Pas pauzës ndërpritet seanca plenare e Kuvendit të Kosovës.